



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:134546

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06316590

**2024:134547**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.H nga Ferizaj me nr. personal .... të cilin e përfaqëson av. Rafiz Shehu nga Ferizaj, kundër të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme, Stacioni Policor në Ferizaj, të cilin e përfaqëson avokatura shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e Kosovës, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, vlera e kontestit 2049,93 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 17.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES**

**I. APROVOHET SI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditësit A.H nga Ferizaj dhe **DETYROHET** i padituri Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme, Stacioni Policor në Ferizaj, që paditësit në emër të pagës së 13-të për vitet 2020, 2021 dhe 2022 t'ia kompensojë shumën totale prej 2049,93€ (dymijë e katërdhjetë e nëntë euro e nëntëdhjetë e tre cent), dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë nga data 13.05.2024 e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**II. DETYROHET** i padituri Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme, Stacioni Policor në Ferizaj që paditësit A.H nga Ferizaj të ja kompensojë shpenzimet procedurale në lartësinë prej 135,00€ në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Paditësi më datë 13.05.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, vlera e kontestit 2049,93 euro, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Policinë e Kosovës, në punët dhe detyrat e Zyrtarit Policor në Ferizaj-polic i lartë ku edhe më tutje vazhdon të punojë. Paditësi që nga viti 2020 ka vlerësim plotësisht të kënaqshëm, e po ashtu nuk ka asnjë masë disiplinore të shqiptuar ku si prove është formulari i vlerësimit të performancës, për vitin 2020, 2021, 2022. Më tutje ka theksuar se paditësi i ka plotësuar kushtet për pagën e fund vitit mbështetur në vërtetimet e lartcekura ndërsa baza juridike e kërkesëpadi së mbështetet në Udhëzimin Administrativ, nr.02/2018, Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, e cila është në fuqi që nga data 14.11.2018, përkatësisht në kapitullin e VI Paga dhe Sistemimi i Personelit të Policisë, neni 29, paragrafi 2. Në parashtresën për precizimin e padisë të dt. 10.10.2024, paditësi përmes të përfaqësuesit të tij av. Rafiz Shehu nga Ferizaj kanë bërë precizimin e kërkesëpadi së paditësit dhe kanë kërkuar që të APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit A.H nga Ferizaj dhe DETYROHET i padituri Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës-Drejtoria e Përgjithshme, Stacioni Policor në Ferizaj, që paditësit në emër të pagës së 13-të për vitet 2020, 2021 dhe 2022 (paga mujore është në shumën prej 686.31€) t'ia kompensojë shumën totale prej 2049,93€ (dymijë e katërdhjetë e nëntë euro e nëntëdhjetë e tre cent), dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar prej ditës së ushtrimit të padisë nga data 13.05.2024 e gjer në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi C.nr....., të dt. ...., të cilin përfaqësuesi ligjor i të paditurit Avokatura Shtetërore-Ministria e Drejtësisë së bashku me shkresat e lëndës e ka pranuar me datë 20.08.2024, fakt të cilin gjykata e konfirmoi nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës e datës 20.08.2024.

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me shkresat e lëndës në këtë çështje juridike kontestimore, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ke gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, paragrafi 1, pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, se të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesepadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Gjykata nga provat që i janë bashkëngjitur padisë ka vërtetuar faktin se në bazë të vërtetimit të punësimit të dt. 08.05.2024 paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga dt. 10.05.2005 me pagë prej 686.31€, kurse nga formulari i vlerësimit të performancës për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, 01.02.2021-31.12.2021 dhe 01.01.2022-31.12.2022, rezulton që ka pasur vlerësim të kënaqshëm të performancës. Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së. Andaj, meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076, për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 213/2023 të datës 09.10.2023. Në nenin 55 par. 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 ku përcaktohet se: “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Në nenin 44 par. 2 të Ligjit nr. 04/L-076, për Policinë, përcaktohet se: “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”. Ndërsa neni 55 par. 1 nën par. 1.7 i këtij Ligji përcakton se: “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2 të nenit 44 të këtij ligji”. Në nenin 5 par. 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: “në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”, ndërsa në pikën 1 të këtij paragrafi parashihet “zyrtarët policor që bëjnë betimin dhe të cilët kanë autoritet t’i ushtrojnë autorizimet dhe detyrat policore”. Ndërkaq në nenin 29 par. 2 të

këtij udhëzuesi është paraparë se “personelit të policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”. Pastaj, sipas pikës II. të mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, parashihet se në kontestet nga marrëdhënia e punës- lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018 dhe në bazë të nenit 30 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve në rastin konkret për paditësin, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit të lëshuar nga e paditura, e nga e cila rezultoi paga të cilën e realizoi paditësi dhe përvojën e punës tek e paditura, andaj paditësit ju njoh e drejta në kompensim ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi, ka vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtë nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, përgjatë viteve të kërkuara me kërkesëpadi. Gjykata, vlerëson se e paditura ka detyrim sipas dispozitave të lartpërmendura, që t’ia kompenzoj paditësit pagat e trembëdhjeta duke u bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382, par. 2 i LMD-së dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme për kamatat të datës 02.12.2020.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 452 dhe 463 të LPK-së dhe TOAK, sipas të cilave paditësit ju pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 104,00 € në emër të përpilimit të padisë dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 31,00€. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet e tjera të kërkuara, meqenëse përpilimi i parashtrësës për precizim të padisë nuk hyn në grupin e parashtrësave për të cilat paguhet kompensimi sipas TOAK.

Meqë me kërkesëpadinë e paditësit është kërkuar shuma prej 2049,93 € por në bazë të llogaritjes matematikore të 3 pagave të fundvitit me nga 686,31€ aq sa shkruan në vërtetimin e punësimit, rezultoi që shuma adekuate duhet të jetë 2,058.93€, por pasi që paditësi ka kërkuar

shumën prej 2049,93 €, gjykata konform nenit 2 të LPK vendosi brenda kufijve të kërkesave të parashtruar nga paditësi.

Nga të lartëcekurat dhe bazuar në nenin 150 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Datë 17.10.2024**

**Gjyqtari,**

**Armend Ahmeti**

**Udhëzimi mbi mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimet të tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.